

BUXHETIT SHTETËROR PUBLIK DHE AUDITIMI I SHPENZIMEVE NGA KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

nga Alush ZAÇE¹ – Kryeauditues,

botuar në gazetën “Shqip”, më 05 maj 2015.



Ndryshimet në nenin 36 të Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, për sa i përket zhvillimit të procedurave të prokurimit nëpërmjet sistemit elektronik, ka qenë një hap shumë i rëndësishëm në luftën kundër korrupsionit në fushën e prokurimeve publike, si një nga fushat më të ndjeshme ndaj korrupsionit.

KLSH, si institucioni i pavarur më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm, me detyrimin që i ngarkon ligji 514/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, kryen auditimin e përdorimit, administrimit dhe mbrojtjes së fondeve publike në përputhje me Kushtetutën, ligjet, aktet nënligjore, manualët në fuqi, si dhe standardet ndërkombëtare të auditimit të INTOSAI-t. Këto auditime kryen në mënyrë të vazhdueshme në njësitë e qeverisjes qendrore dhe asaj vendore edhe në fushën e rëndësishme të prokurimeve. Auditimet në fushën e prokurimeve ndikojnë pozitivisht në

luftën kundër korrupsionit, si premtim i politikës ndaj taksapaguesve shqiptarë, por edhe si plotësim i detyrimeve për integrimin evropian.

Rëndësia e auditimit të prokurimeve publike vjen edhe si rezultat i kërkesave të organizatave ndërkombëtare, të cilat detyrojnë që të merren masat e nevojshme për të përmirësuar sistemet e prokurimeve, bazuar në kriteret e transparencës dhe konkurrencës së ndershme si dhe vlerësimin e pavarur të sistemeve kombëtare të prokurimeve publike.

Gjatë auditimeve në fushën e prokurimeve të punëve, mallrave dhe shërbimeve, nga ana e KLSH-së janë hasur shkelje dhe mangësi që kanë shmangur konkurrimin e ndershëm duke devijuar nga Ligji “Për prokurimin publik”, qëllimi i të cilit është të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit dhe të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.



Kryerja e procedurave të prokurimit publik nëpërmjet sistemit elektronik, i kufizon strukturat prokuroese për shkeljen e ligjit. Këto struktura “stërmundohen” për të gjetur

mënyrën “ligjore” për të favorizuar klientët e vet, apo për të përfituar edhe financiarisht për shkak të detyrës. Metodatat e sofistikuar tani nuk janë më vetëm në skualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomikë, por kanë të bëjnë me hartimin e dokumenteve të tenderit, kërkesave të veçanta për

kualifikim dhe specifikimeve teknike, që në shumë raste janë hartuar qëllimshëm për të mos mundësuar trajtim të njëjtë për të gjithë ofertuesit, duke u bërë pengesë për një konkurrim të drejtë. Gjatë auditimeve të kryera nga KLSH, janë zbuluar raste kur kërkesat e veçanta për kualifikim janë hartuar jo të lidhura ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës. Këto kërkesa duket sikur janë të hartuara në zyrat e operatorëve ekonomikë të privilegjuar, kandidatë për fitimin e tenderit dhe jo në zyrat e shtetit. Kjo ka bërë që nga ana e Autoriteteve Kontraktore të mos krijohen kushte të përshtatshme për konkurrim të paanshëm ndërmjet kandidatëve ofertues, duke përcaktuar paraprakisht fituesin e tenderit, në kundërshtim të plotë me Ligjin, i cili kërkon nga autoritetet kontraktuese që të hartojnë kërkesa në mënyrë që të sigurohet një qasje sa më e madhe e mundshme për të gjithë operatorët dhe ofertuesit e interesuar ekonomikë dhe në të njëjtën kohë, të mos përpilojnë kërkesa që favorizojnë një ose më shumë operatorë.

Veprime të tilla, përveç se kanë ulur besimin publik në strukturat shtetërore në lidhje me paanshmërinë në prokurimin e fondeve publike, në shumicën e rasteve shoqërohen me përdorimin e këtyre fondeve pa ekonomikitet, pasi për të njëjtën punë të parashikuar për tu kryer, harxhohen më shume para nga taksapaguesit.

Por, me gjithë punën e vazhdueshme të KLSH-së, strukturat e realizimit të prokurimit publik, në shumë raste, nuk marrin masa për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga KLSH, qoftë për përmirësimin e gjendjes nëpërmjet masave organizative, qoftë për masat disiplinore. Gabimet e përsëritura janë të pafalshme. Në shumë raste, (le ta themi hapur atë që nëpunësit e thonë nën zë) strukturat e prokurimit publik urdhërohen nga

eprorët duke i kërcënuar edhe me vendin e punës. Ka ardhur koha që t'i thuhet "stop" kësaj mendësie. Metafora e lojës së shahut, ku "sakrifikohen ushtarët për figurat", duhet të marrë fund përgjithmonë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik dhe Agjencia e Prokurimit Publik duhet të bashkërendojnë punën dhe të mbështesin pa rezerva përpjekjet e strukturave të KLSH-së për të luftuar korrupsionin në fushën e prokurimeve publike. Vetëm nëpërmjet kësaj sinergjie, do të mundim të shërojmë këtë gangrenë të shoqërisë shqiptare në periudhën e stërzgjatur të tranzicionit, duke i detyruar institucionet që të sigurojnë një mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut dhe lirinë e aktivitetit ekonomik, si dhe të drejta ligjore të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë, duke minimizuar mundësinë e shpërdorimit të parasë së taksapaguesve.

Kontrolli i Lartë i Shtetit, sot dhe në të ardhmen, është i vendosur për tolerancë zero ndaj këtij fenomeni, duke bashkëpunuar me organin e akuzës, për të frenuar abuzimin me paranë dhe interesat publike për përfitime private si dhe për të ndikuar në rritjen e besimit publik ndaj qeverisjes.

¹ *Shkrime të tjera të botuara nga Alush ZAÇE dhe Bexhet ZEQIRI për periudhën janar-qershor 2015:*

- *Buxheti Shtetror publik dhe auditimi i shpenzimeve nga KLSH.*
(Botuar në gazetën "Telegraf", më 16 maj 2015.)